



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**MIRATOHET**

KRYETAR I K.K.T-së

**Z. EDI RAMA**

MINISTER I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**Znj. BELINDA BALLUKU**

Kryetar i Këshillit Bashkiak

**Z. ILIR HALAJ**

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. 48, datë 31.10.2022

Kryetar i Bashkisë

**Z. TONIN MARINA**

**DOKUMENTI I RISHIKIMIT TË  
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR  
BASHKIA MALËSI E MADHE**

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 2, datë 14.12.2022

Drejtoria e Planifikimit Urban, Projekteve dhe Kadastrës: **Ing. ERMELINDA VOLAJ**



# PËRMBAJTJA

KREU I.....	3
NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PLANIT .....	3
KREU II.....	14
NDRYSHIME NË TABELAT E TREGUESVE TË ZHVILLIMIT TË NJËSIVE STRUKTURE	14
<i>SHTOJCA I</i> .....	26
<i>HARTAT ILUSTRUESE E NJËSIVE STRUKTURE ME NDRYSHIME</i> .....	26
<i>SHTOJCA II</i> .....	28
<i>KOORDINATAT E NJËSIVE STRUKTURE QË PËSOJNË NDRYSHIME TË KUFIJVE</i> .....	28
<i>SHTOJCA III</i> .....	29
<i>PARAQITJA GRAFIKE E MBIVENDOSJES SË FASHAVE MBROJTËSE/TË REZERVIMIT TË RRUGËVE KOMBËTARE ME PLANIN E PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË MALËSIE MADHE DHE LISTA E NJËSIVE STRUKTURE PËRKATËSE</i> .....	29



# KREU I

## NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PLANIT

Në "Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Malësi e Madhe", bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në nenin 15 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pas pikës 6, shtohet pika 7 me përmbajtje si më poshtë:

7. Duke konsideruar që rregulli për madhësinë minimale të parcelës për zhvillim është orientues dhe në kushtet kur madhësitë e parcelave janë të përmasave të ndryshme (jo të standardizuara), atëherë autoriteti i zhvillimit duhet të mbajë në konsideratë rregullat si më poshtë:

- a) Në rastin e parcelës minimale 500m<sup>2</sup> ose 600m<sup>2</sup>, do të lejohet zhvillimi edhe nëse parcela është deri në 15% më e vogël se parcela minimale e lejuar;
- b) Në rastin e parcelës minimale 1.000m<sup>2</sup> do të lejohet zhvillimi edhe nëse parcela është deri në 12% më e vogël se parcela minimale e lejuar.
- c) Në rastin e parcelës minimale 5.000m<sup>2</sup> do të lejohet zhvillimi edhe në rast se parcela është deri në 8% më e vogël se parcela minimale e lejuar.

2. Në nenin 18 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pas pikës 5 shtohen pikat 6, 7 dhe 8 me përmbajtje si më poshtë:

6. Për parcelat që shtrihen në dy apo më shumë përdorime të ndryshme, lejohet përfshirje e të gjithë sipërfaqes së parcelës në përllogaritjen e intensitetit të ndërtimit në territorin me përdorimin e tokës me mundësi më të madhe zhvillimi vetëm nëse:

- a) Parcela ka mbi 50 % të sipërfaqes së saj, në njësinë me tregues zhvillimi më të lartë;
- b) Pronari, apo zhvilluesi e kërkon mundësinë e zhvillimit të gjithë parcelës me të drejta më të larta zhvillimi, me qëllim që të gjenerojë zgjerim të hapësirave me interes publik apo zhvillim në funksion të shtimit të shërbimeve të munguara në zonë.

7. Parcelat, të cilat shtrihen në më shumë se një njësi strukturore me mundësi të ndryshme zhvillimi, mund të përfshihen në njësinë strukturore me mundësi më të madhe zhvillimi, vetëm nëse plotësohen dy kushtet e mëposhtme njëkohësisht:

- a) Një mundësi e tillë kërkohet nga pronari, apo zhvilluesi, dhe;
- b) Parcela/t ka/në mbi 50% të sipërfaqes së saj/tyre në atë njësi strukturore me tregues zhvillimi më të lartë.

8. Për të gjitha rastet e tjera, parcela do të parashikohet me mundësi të ndryshme zhvillimi, sipas kufirit të njërive strukturore, të cilat do të orientojnë zhvilluesit për riparcelizimet e nevojshme sipas mënyrave të zhvillimit të përcaktuara në këtë rregullore dhe planet e detajuara vendore.



3. Në nenin 29 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pas pikës 1, shtohen pikat 1.1 deri në 1.6 si më poshtë:

1.1 "Vija blu", sipas përcaktimeve të VKM Nr. 686/2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" është vija kufizuese e zhvillimit me funksion mbrojtjen e të gjitha burimeve ujore.

1.2 "Brigjet", janë rripat anësorë të tokës përgjatë deteve, liqeneve, rezervuarëve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrenjve.

1.3 "Burimet ujore", janë të gjitha ujërat e brendshme detare, ujërat territoriale, vija bregdetare, zona ekonomike ekskluzive, shelfi kontinental, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse, reshjet atmosferike, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

1.4 Veprimtaritë përbri brigjeve, përcaktohen në planet dhe studimet e planifikimit dhe rregullimit të territorit si dhe në zbatim të legjislacionit sektorial në fuqi.

1.5 Bazuar në këto dispozita "vija blu" në Planin e Përgjithshëm Vendor të bashkisë Malësi e Madhe përcaktohet nga kufiri i njëjësive strukturore pjesë e Sistemit Urban që përballen me burimin ujor, dhe në çdo rast "vija blu" duhet të respektojë brigjet ujore, duke mos i tejkaluar ato. Në përcaktimin e vijës blu mbahen në konsideratë edhe përcaktimet e VKM Nr.748, datë 01.12.2022 "Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore".

1.6 Në rastet kur vija blu e PPV-së tejkalon bregun e përcaktuar me vendime të posaçme të KKU-së, me VKM apo vendime të tjera (sipas legjislacionit sektorial në fuqi), prevalojnë kufizimet/kushtëzimet/rregullat për bregun sipas dispozitave përkatëse.

4. Pas nenit 29 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, shtohet neni 29/1 me përmbajtje si më poshtë:

**NENI 29/1: Kufizimi i ndërtimeve përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C**

1. Aplikimi për t'u pajisur me leje zhvillimi dhe ndërtimi në të gjitha njësitë strukturore, të cilat shtrihen përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C, për atë territor (pjesë të njësisë) që mbivendoset me brezin e rezervuar, referuar Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor, duhet të kryhet pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, dhe të paraprihet nga konfirmimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar (për lidhje me, apo dalje në rrugën nacionale), duke qenë se këto njësi janë pjesë e brezit të rezervuar të rrugëve nacionale, zona të rëndësisë kombëtare në planifikim.
2. Lejet e zhvillimit dhe të ndërtimit për struktura përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C duhet të merren në shqyrtim vetëm nëse strukturat e propozuara kanë akses në rrugë e shërbimit, ose kanë autorizim nga ARRSH për lidhje/ dalje në rrugë nacionale".
3. Çdo zhvillim në këto njësi duhet të shoqërohet me një brez gjelbërimi të përbërë minimalisht nga dy rreshta bimësie të lartë, paralel me rrugën nacionale, që do të shërbejnë si zonë tampon mes zhvillimit të propozuar dhe vetë rrugës nacionale të shpejtësisë së lartë".



4. Në çdo rast brezi i rezervuar i rrugëve të kategorisë A, B dhe C duhet të mbetet i lirë nga ndërtimet, përveç strukturave për shërbime që i shërbejnë transportit dhe lejohen nga Kodi Rrugor”.
5. Pas nenit 33 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor shtohet neni 33/1 me përmbajtje si më poshtë:

**NENI 33/1: Rastet për të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm**

1. Hartimi i Planit të Detajuar Vendor për njësitë strukturore të përcaktuara si subjekt hartimi i PDV-së, nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm në rastet e mëposhtme të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni. Në këto raste, projektet mund të vijojnë procedurat për pajisjen me leje zhvillimi/ ndërtimi, apo deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve, dhe të tjera të ngjashme, pa pritur hartimin dhe miratimin e PDV-së, por në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në fushën e zhvillimit të territorit dhe Planin e Përgjithshëm Vendor.
2. Gjatë hartimit të PDV-së, projektet e miratuara sipas përcaktimeve të këtij neni, duhet të integrohen në PDV.
3. Rastet përjashtimore janë të aplikueshme vetëm në territore që nuk janë pjesë e Zonave të Rëndësishme Kombëtare, Brezit të Zhvillimit të Kontrolluar e Zonave me Përparësi Zhvillimore Turizmit dhe përkufizohen si më poshtë:
  - a. Për punime në infrastrukturë, të cilat nuk ndryshojnë treguesit e zhvillimit të njësisë strukturore të PPV-së.
  - b. Për punime që kanë si pasojë prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri, përveç rasteve të parashikuara në këtë nen.
  - c. Për ndërtime të përkohshme.
  - d. Për punime që realizojnë mirëmbajtje të jashtëzakonshme të objektit.
  - e. Për punime si pasojë e emergjencave civile.
  - f. Për punime që përmirësojnë aksesin e ndërtesave e strukturave për personat me aftësi të kufizuara.
  - g. Kur kërkohet miratimi i projekteve për objekte dhe infrastrukturë publike, në respektim të parashikimeve të PPV-së. Treguesit e zhvillimit të dhëna për njësinë përkatëse do të jenë kufizuese për pronat subjekt i këtij rasti përjashtimor.
  - h. Kur kërkohet të kryhen punime për ndërhyrje që, sipas legjislacionit në fuqi, nuk kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/ ndërtimi ose realizohen përmes deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve.
  - i. Kur kërkohet rikonstruksion, riparim dhe restaurim i një objekti ekzistues, për sa kohë këto punime nuk ndryshojnë treguesit e zhvillimit të objektit ekzistues.
  - j. Kur kërkohet rindërtimi i një banese të degraduar për ta kthyer atë në kushte të përshtatshme jetese, duke realizuar treguesit si KSHT, lartësia në kate dhe në metra (m), intensiteti i ndërtimit dhe distancat nga kufiri i pronës dhe objektet fqinjë, me vlera më të



ulëta apo me të njëjtën vlerë si në gjendjen ekzistuese, ose sipas legjislacionit në fuqi (nëse ka parashikime të tilla).

k. Kur kërkohet rikonstruksioni i një banese ekzistuese me shtesë vëllimi, anësore apo në lartësi për qëllime që lidhen me banimin, për sa kohë objekti i rikonstruktuar nuk tejkalon treguesit e zhvillimit të njësisë strukturore. Në çdo rast, shtesa në lartësi nuk duhet të jetë më shumë se 1 kat dhe objekti të mos kalojë lartësinë 3 kat.

l. Kur kërkohet zhvillimi i një banese një-familjare, e cila plotëson kushtet si më poshtë:

i. Është banesa e parë/ kryesore e banimit.

ii. Zhvillimi i tokës për banim me struktura një-familjare, është përdorim i lejuar nga PPV-ja në njësinë strukturore ku kërkohet zhvillimi.

iii. Lartësia maksimale e kërkesës për zhvillim është 2 kat/ 8m, ndërsa sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë është jo më shumë se 250 m<sup>2</sup>.

iv. Përveç kushteve të zhvillimit të përcaktuara në gjurmën "iii", kërkesa për zhvillim duhet të respektojë treguesit e tjerë të zhvillimit, sipas atyre të lejuara për njësinë strukturore të PPV-së.

v. Në rast se, treguesit e zhvillimit të njësisë për lartësinë e objektit, sipërfaqen totale të ndërtimit dhe parcelën minimale, janë më të vogla se ato të përcaktuara në gjurmën "iii", më sipër, atëherë mbizotërojnë dhe zbatohen treguesit e zhvillimit të njësisë strukturore."



6. Pas nenit 36 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor shtohen nenet 36/1 dhe 36/2, me përmbajtje si më poshtë:

**Neni 36/1: Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror**

1. Në njësitë që i përkasin sistemit Urban, Bujqësor dhe Natyror lejohet zhvillimi i objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, objekteve agroturistike dhe ekoturistike si dhe objekteve sportive, ambienteve sportive, terreneve sportive dhe mjediseve sportive ku zhvillohen një ose disa sporte, në bazë të rregullave teknike, me kusht:

a. Respektimin e përcaktimeve ligjore në fuqi në fushën e bujqësisë, natyrës, mjedisit, pyjeve e kullotave, zonave të mbrojtura, sportit, etj, sipas territorit specifik;

b. Respektimin e përcaktimeve ligjore sektoriale në fushën e agroturizmit dhe ekoturizmit;

c. Bashkërendimin dhe marrjen e konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe zonave të rëndësisë kombëtare, sipas legjislacionit në fuqi;

d. Respektimin e kontekstit natyror/bujqësor dhe ruajtjen e peizazhit rural;

e. Sigurimin e pajisjes së strukturave të veprimtarisë agro/ekoturistike me infrastrukturën inxhinierike të nevojshme, sipas legjislacionit përkatës;

f. Moscënimi i infrastrukturës në funksion të tokës bujqësore (kanale kullues/vaditës, rrugë bujqësore, rezervuar, etj).

2. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në pasaportën e njësisë strukturore përkatëse apo nga legjislacionit në fuqi, strukturat agroturistike nuk duhet të kalojnë 2 kate me nënçati, ndërsa



- strukturat sportive, duhet të zbatojnë standartet dhe kushtet teknike të projektimit për objekte, ambiente, terrene dhe mjedise sportive.
3. Riparimi, rinovimi, shtesat dhe përshtatja e strukturave ekzistuese të funksioneve të ndryshme në struktura në funksion të agroturizmit, ekoturizmit dhe sporteve është e lejuar me përmbushjen e përcaktimeve të këtij neni dhe në çdo rast, duke respektuar legjislacionin sektorial në fuqi. Strukturat ekzistuese mund të zgjerohen në respektim të pikës 2 të këtij neni.
  4. Bashkia duhet të vijojnë me miratimin e kërkesave për leje zhvillimi/ndërtimi për rastet sipas pikës 1 të këtij neni, vetëm pas:
    - a. marrjes së konfirmimit nga Ministria e Linjës dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit për objektet për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale dhe objektet agroturistike/ekoturistike;
    - b. marrjes së konfirmimit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit për objektet sportive, ambiente sportive, terrene sportive dhe mjedise sportive;
    - c. njoftimit të Këshillit Kombëtar të Territorit.
  5. Nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të strukturave sipas pikës 1 të këtij neni në vijimësi.

**NENI 36/2: Kushte për objektet ekzistuese në sistemin Bujqësor dhe Natyror**

1. Strukturat e banimit (kategoria A-Banim, BA-Bujqësi-Banim), ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së, të përfshira në sistemin Bujqësor dhe atë Natyror, mund t'i nënshtrohen rikonstruksionit dhe rindërtimit, me të drejtë shtesë mbi sipërfaqen e përgjithshme të tyre, vetëm një herë.
2. Strukturat e banimit mund të rikonstruktohen si dhe rindërtohen duke shtuar mbi parametrat e gjendjes ekzistuese 1 kat ose 30% të sipërfaqes totale pa kaluar lartësinë maksimale 3 kat. Në rast shtese të vëllimit anësor, shtesa duhet të lejohet vetëm nëse plotësohet kushti që toka të mos ketë bonitet të kategorisë I-IV. Në këto raste (shtesa të vëllimit anësor) koeficienti total i shfrytëzimit të parcelës për ndërtim nuk duhet të kalojë 50%.
3. Strukturat ekzistuese të funksionit banim të përfshira në brezat buferik/brezat e rezervimit të burimeve ujore, varrezave, infrastrukturave rrugore, monumenteve të natyrës, monumenteve të kulturës, etj, mund t'i nënshtrohen punimeve të rikonstruksionit sipas përcaktimeve të legjislacionit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në fuqi, pa shtesa volumore anësore apo në lartësi.
4. Strukturat ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së dhe të paregjistruara, i nënshtrohen procedurave në fuqi për legalizimin dhe regjistrimin në Kadastër, edhe në rastet kur përcaktimet e Planit për përdorimin e tokës dhe treguesit e zhvillimit nuk lejojnë zhvillimin, rihvillimin, ristrukturimin, apo forma të tjera ndërhyrje në territorin ku ato ndodhen.
5. Rekomandohet transformimi i strukturave ekzistuese: ish reparte ushtarake jashtë funksionit, banesa, struktura apo objekte sot pa funksion në struktura të Shërbimeve – nënkategoria S1-Shërbime Akomodimi dhe Argëtimi dhe/ose EB3-Agroturizëm. Këto struktura mund të pasurohen me struktura ekologjike Ekoturizmi NAR4 si dhe hapësira për kampingje me çadra.



6. *Strukturat e shërbimit (S-Shërbime), ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së, të përfshira në sistemin Bujqësor dhe atë Natyror, mund t'i nënshtrohen rikonstruksionit dhe/ose rindërtimit, me të drejtë shtese mbi gjurmën ekzistuese, vetëm në lartësi, vetëm një herë dhe pa kaluar lartësinë maksimale 3K.*

7. *Strukturat industriale-ekonomike (IE-Industri dhe Ekonomi), ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së, të përfshira në sistemin Bujqësor dhe atë Natyror, mund t'i nënshtrohen rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes (në kushtet e emergjencës) pa të drejtë shtese vëllimore. Në vazhdimësi, në bashkëpunim me subjektet private-pronare, bashkia duhet të marrë masat për rivendosjen/ zhvendosjen e tyre në territoret e përcaktuara për përdorim të kategorisë IE\_Industri dhe Ekonomi.*

7. Në nenin 41 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:

i. Në shkonjën "A. Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet për zhvillim", pika "7- Kushte për PDV", shtohet fraza "Përjashtim bën njësia KA\_05-A13-07, për të cilën nuk ka nevojë të hartohet PDV".

ii. Në shkonjën "B. Rregullat e volumit", pika "5-Lartësia maksimale e lejuar", shtohet fraza "Përjashtim bën njësia KA\_05-A13-07, për të cilën lartësia është 5K".

8. Në nenin 42 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:

i. Në titullin e shkonjës A shtohet fraza "Këto kushte nuk aplikohen për njësinë strukturore KO\_03-A14-12".

ii. Në shkonjën "A. Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet për zhvillim", pika "7-Kushte për PDV", shtohet fraza "Përjashtim bën njësia KO\_03-A14-09, KO\_03-A14-10 dhe njësia KO\_03-A14-13, për të cilat nuk ka nevojë të hartohet PDV".

iii. Në titullin e shkonjës B shtohet fraza "Këto rregulla nuk aplikohen për njësinë strukturore KO\_03-A14-12".

iv. Në shkonjën "B. Rregullat e volumit", pika "5-Lartësia maksimale e lejuar", shtohet fraza "Përjashtim bën njësia KO\_03-A14-13, për të cilën lartësia është 3K".

9. Në nenin 46 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:

i. Në shkonjën "B. Rregullat e volumit":

a. pika "2-Koeficienti maksimal i shfrytëzimit", shtohet fraza "Përjashtim bën njësia QE\_02-A23-02, për të cilën KSHT është 30%";

b. pika "4-Koeficienti minimal për hapësira publike të hapura", shtohet fraza "Përjashtim bën njësia QE\_02-A23-02, për të cilën KSHP është 50%";

10. Në nenin 48 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:

i. Në shkonjën "B. Rregullat e volumit":



- a. Pika "1-Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit për zonën", shtohet fraza "Përjashtim bën njësia KE\_05-A31-05, për të cilën intensiteti është 1.2";
- b. pika "2-Koeficienti maksimal i shfrytëzimit", shtohet fraza "Përjashtim bën njësia KE\_05-A31-05, KE\_05-A31-06 dhe KE\_05-A31-08 për të cilat KSHT është 35%";
- c. pika "5-Lartësia maksimale e lejuar", shtohet fraza "Përjashtim bën njësia KE\_05-A31-05, për të cilën lartësia është 3K dhe njësia KE\_05-A31-06 dhe KE\_05-A31-08, për të cilat lartësia është 4K.

**11. Në nenin 49 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:**

- i. Në shkonjën "B. Rregullat e volumit":
  - a. pika "1-Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit për zonën", shtohet fraza "Përjashtim bën njësia KE\_01-A32-10, për të cilën intensiteti është 0.5";
  - b. pika "2-Koeficienti maksimal i shfrytëzimit", shtohet fraza "Përjashtim bëjnë njësitë KE\_01-A32-07 dhe KE\_01-A32-10, për të cilat KSHT është 35%";
  - c. pika "3-Koeficienti minimal për rrugë", shtohet fraza "Përjashtim bën njësia KE\_01-A32-01, për të cilën KSHR është 15%";
  - d. pika "5-Lartësia maksimale e lejuar" shtohet fraza "Përjashtim bëjnë njësitë KE\_01-A32-07 dhe KE\_01-A32-10, për të cilat lartësia është 3K dhe njësia KE\_01-A32-01, për të cilën lartësia është 2K + nënçati e shfrytëzuar 50%".



**12. Në nenin 50 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:**

- i. Në shkonjën "B. Rregullat e volumit":
  - a. pika "1-Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit për zonën", nga "0.2 e parcelës individuale" shtohet fraza "Përjashtim bën njësia SH\_08-A33-05, për të cilën intensiteti është 1";
  - b. pika "2-Koeficienti maksimal i shfrytëzimit", shtohet fraza "Përjashtim bën njësia SH\_08-A33-05, për të cilën është koeficienti maksimal i shfrytëzimit është 30%";
  - c. pika "5-Lartësia maksimale e lejuar", shtohet fraza "Përjashtim bën njësia SH\_08-A33-05, për të cilën lartësia maksimale e lejuar është 3K/ 11metra".

**13. Në nenin 51 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:**

- i. Në shkonjën "A. Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet për zhvillim", pika "7-Kushte për PDV",
  - a. Pas paragrafit të dytë shtohet paragrafi i tretë, me përmbajtje: "Përjashtim bëjnë njësitë KE\_02-A34-01, KE\_02-A34-02 dhe KE\_02-A34-03, për të cilat nuk ka nevojë të hartohet PDV"



b. fraza “Njësia KE\_02-A34-01 do të trajtohet me PDZRK së bashku me njësitë KE\_02-S-01 dhe KE\_02-S-02” ndryshon në “Njësitë KE\_02-S-01 dhe KE\_02-S-02 do të trajtohen me PDZRK”;

ii. Në shkonjën “B. Rregullat e volumit”:

a. pika “5-Lartësia maksimale e lejuar”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KE\_02-A34-01, për të cilën lartësia është 4K”.

**14. Në nenin 54 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:**

Në shkonjën “A. Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet për zhvillim”, pika “7-Kushte për PDV”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KA\_04-IE2-01, për të cilën nuk ka nevojë të hartohet PDV”.

iii. Në shkonjën “B. Rregullat e volumit”:

d. pika “3-Koeficienti minimal për rrugë”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KA\_04-IE2-01, për të cilën KSHR është 20%”;

e. pika “4-Koeficienti minimal për hapësira publike të hapura”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KA\_04-IE2-01, për të cilën KSHP është 20%”;

**15. Në nenin 55 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:**

i. Në shkonjën “A. Parashikime të përgjithshme, rregullat e përdorimit dhe kushtet për zhvillim”:

a. pika “7-Kushte për PDV”, fraza “Njësitë KE\_02-S-01 dhe KE\_02-S-02 që do të trajtohen me PDZRK së bashku me njësinë KE\_02-A34-01.” ndryshon në “Njësitë KE\_02-S-01 dhe KE\_02-S-02 që do të trajtohen me PDZRK”.

b. pika “7-Kushte për PDV”, shtohet fraza “Njësia KO\_01-S-01 do të trajtohet me PDV, e cila duhet të bashkërendohet me AKZM-në”.

ii. Në shkonjën “B. Rregullat e volumit”:

a. pika “2-Koeficienti maksimal i shfrytëzimit”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KE\_05-S-01, për të cilën KSHT është 50%”.

**16. Në nenin 65 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pika 3 ndryshon si më poshtë:**

“3. Parametrat e zhvillimit dhe funksionet sipas kategorisë AR3 do të përcaktohen në lejet e zhvillimit, në përputhje me nevojat e vendbanimit si dhe duke respektuar intensitetin maksimal 2”.

**17. Në nenin 68 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pika 3 riformulohet si më poshtë:**

3. Varrezat duhet të jenë të izoluara nga zonat e banimit nëpërmjet brezit të rezervuar. Ndalohen ndërtime të reja apo të zgjerohen ato ekzistuese brenda brezit të rezervuar.



*Në qendrat e banuara me popullsi mbi 10.000 banorë, gjerësia e zonës së rezervuar duhet të jetë më e madhe se 100 metra nga vija kufizuese e qendrës së banuar dhe për ato me popullsi më të vogël se 10.000 banorë, duhet të jetë më e madhe se 50 metra.*

*Këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe, ka të drejtë të zvogëlojë gjerësinë e brezit të rezervuar, vetëm me vendim të motivuar të tij dhe duke marrë mendimin e Inspektoriatit Sanitar.*

*Varreza private mund të ngrihen nga subjekte private mbi troje në pronësi të tyre. Ngritja e varrezave private do të bëhet me miratim të Këshillit të Bashkisë. Kriteret dhe procedurat për ngritjen e varrezave private përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

**18. Në nenin 77 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pas pikës 3, shtohen pikat 4 deri në 7, me përmbajtje si më poshtë:**

4. Njësitë të cilat preken nga kalimi i linjave ose kanë si pjesë përbërëse/kufizohen nga Hekurudha duhet të zbatojnë kuadrin ligjor të Ligjit Nr. 142, datë 22.12.2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”.
5. Përkufizime:
  - a. “Brez i vijës hekurudhore” është toka në të dyja anët e vijës hekurudhore, me gjerësi minimale 5 metra, duke u nisur nga fundi i skarpatës së trasesë, kur nuk ka kanale, dhe nga fundi i kanaleve mbrojtëse dhe kulluese.
  - b. “Brez mbrojtës i vijës hekurudhore” është brezi i tokës nga të dyja anët e vijës hekurudhore, me gjerësi 100 metra, nisur nga ekstremi i jashtëm i brezit të vijës hekurudhore.
  - c. “Hapësirë ajrore hekurudhore” është hapësira mbi linjën hekurudhore, në lartësi 12 metra nga niveli i kokës së shinës, në të gjithë gjerësinë e brezit të vijës hekurudhore, ndërsa në kryqëzimet me linjat elektrike mbi 220 kilovolt hapësira është 14 m.
6. Në funksion të mbrojtjes së vijës hekurudhore, si dhe për të siguruar mbrojtjen e vijave hekurudhore ndalohet:
  - a. hapja më afër se 100 metra nga brezi i vijës hekurudhore i guroreve, zhavorrishteve e ranishtave, gërmimi masiv i dheut dhe hapja e kanaleve. Për ndërtimin e këtyre objekteve, në distancë 100-200 metra nga brezi i vijës hekurudhore, merret leje nga administruesi i infrastrukturës hekurudhore;
  - b. Çdo lloj ndërtimi, hapja e puseve, e rezervuarëve dhe e pikave të karburantit, ngritja e përcjellësve elektrikë përgjatë vijës hekurudhore, më pranë se 25 metra nga brezi i kësaj vije, për territoret jashtë zonave urbane. Por, në këto zona lejohet ndërtimi i ndërtesave të banimit dhe i ndërtesave të tjera, hapja e puseve, e rezervuarëve dhe e pikave të karburantit, ngritja e përcjellësve elektrikë përgjatë brezit të vijës hekurudhore, në distancë 25-100 metra nga ky brez.
7. Për ndërtimin e çdo lloj objekti, që ndodhet në zonat urbane, jashtë brezit të vijës hekurudhore dhe në distancë deri në 25 metra nga ky brez, kërkohet leje nga administruesi i infrastrukturës hekurudhore.



**19. Pas nenit 80 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor shtohet neni 80/1 me përmbajtjen si më poshtë:**

***NENI 80/1: Kanalet vaditëse/Emisaret***

1. Njësitë që preken/kanë si pjesë përbërëse, ose kufizuese kanalet vaditëse/emisaret, duhet të zbatojnë kuadrin ligjor të Ligjit Nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”.
2. Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen si të tilla:
  - a. ndërtimi, rehabilitimi ose modifikimi i një sistemi ujitjeje apo kullimi pa lejen përkatëse;
  - b. dëmtimi i sistemit të ujitjes, i sistemit të kullimit ose i veprave të mbrojtjes nga përmytja;
  - c. ndërtimi i paautorizuar mbi sistemet e ujitjes, sistemet e kullimit ose veprat e mbrojtjes nga përmytja;
  - d. ndërtimi i paautorizuar mbi sistemet e ujitjes, sistemet e kullimit ose veprat e mbrojtjes nga përmytja;
  - e. ndërtimi ose ngritja e çdo ndërtese apo strukture, mbjellja e pemëve më afër se **8 metra** nga bordura e kanalit kryesor (vija e takimit të sipërfaqes së tokës me skarpatën e kanalit kullues ose vija e takimit të skarpatës së jashtme të bankinës së kanalit ujitës me sipërfaqen e tokës), ose e një sistemi kryesor kullimi, apo më afër se **4 metra** nga bordura e çfarëdo kanali ujitjeje ose kullimi.



**20. Në nenin 88 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:**

- i. Në shkonjën “B. Rregullat e volumit”:
  - a. pika “1-Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit për zonën”, shtohet fraza “Për njësinë strukturore KA\_01-B2-08, intensiteti është 0.5”;
  - b. pika “2-Koeficienti maksimal i shfrytëzimit”, shtohet fraza “Për njësinë strukturore KA\_01-B2-08, KSHT është 35%”;
  - c. pika “5-Lartësia maksimale e lejuar”, shtohet fraza “Për njësinë strukturore KA\_01-B2-08, lartësia është 1 kat.”;

**21. Në nenin 89 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, bëhet ndryshimi si më poshtë:**

- i. Në shkonjën “Rregullat e zhvillimit per parcela individuale”:
  - a. pika “1-Intensiteti maksimal i lejuar për zonën”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KE\_07-B3-08, për të cilën intensiteti është 0.5”.
  - b. pika “2- Koeficienti maksimal i shfrytëzimit”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KE\_07-B3-08 dhe njësia SH\_10-B3-01, për të cilat KSHT është 15%;
  - c. pika “5- Lartësia maksimale e lejuar”, shtohet fraza “Përjashtim bën njësia KE\_07-B3-08, për të cilën lartësia është 2K+nënçati e shfrytëzueshme 50%”.



22. Në nenin 100 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pas pikës 6, shtohen pikat 7 deri në 9 me përmbajtje si më poshtë:

7. *Kushdo ka të drejtë të përdorë lirisht burimet ujore sipërfaqësore për të pirë dhe për nevoja të tjera shtëpiake e të blegtorisë, pa tejkaluar nevojat, sasitë e nevojshme për plotësimin e nevojave individuale dhe familjare të përdoruesit dhe në përputhje me ligjet dhe planet përkatëse të këshillave të baseneve.*
8. *Ndërtimi i puseve, qoftë për përdorim bujqësor dhe industrial, është i pranueshëm vetëm nëse është në përputhje me përcaktimet e legjislacionit të posaçëm për burimet ujore në fuqi.*
9. *Kushdo ka të drejtë të përdorë ujin e reshjeve të shiut që bie në tokë private, me kusht që ky ujë të mos jetë mbledhur në instalime artificiale me kapacitet grumbullues më të madh se 20m<sup>3</sup>.*





## KREU II

### NDRYSHIME NË TABELAT E TREGUESVE TË ZHVILLIMIT TË NJËSIVE STRUKTUREORE

Në "Tabelat e Treguesve të Zhvillimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Malësi e Madhe", në Rregulloren e Planit, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon. Paraqitja grafike e ndryshimeve do të bëhet sipas koordinatave në Shtojcën II të këtij dokumenti.

1. Në pasaportat e njësive strukturore sipas Shtojcës III, pika a) deri e) të këtij dokumenti, të prekura nga zonat e rezervimit të akseve rrugore:

- a) "Shkodër - Hani i Hotit", kategoria A, sipas PPV (min. 60m nga trupi i rrugës);
- b) "Koplik - Qafë Thore", kategoria C, (min. 30m nga trupi i rrugës);
- c) "Koplik - Qafë Thore", kategoria C, (min. 10m nga trupi i rrugës);
- d) "Hani i Hotit - Tamarë - Vermosh", kategoria C, sipas PPV (min. 30m nga trupi i rrugës);
- e) "Hani i Hotit - Tamarë - Vermosh", kategoria C, sipas PPV (min. 10m nga trupi i rrugës);

shtohet kutiza "Kushtëzime ligjore" me përmbajtje si më poshtë: "Respektimi i përcaktimeve ligjore të VKM Nr.153, datë 07.04.2000 "Për miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

2. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore KE 01-A32-01:

- a) Lartësia, nga "2 kate" ndryshon në "2 kate+nënçati e shfrytëzueshme 50%;
- b) KSHR, nga "20%" ndryshon në "15%".

3. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore KE 01-A32-07:

- a) Lartësia, nga "2 kate" ndryshon në "3 kate;
- b) KSHT, nga "25%" ndryshon në "35%".

4. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore KE 01-A32-02:

- a) Sipërfaqe (ha), nga "26.14" ndryshon në "25.26";
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.

5. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" shtohet njësia strukturore KE 01-A32-10:

- a) Njësia administrative, "Kelmend";
- b) Zonimi në territor, "KE\_01";
- c) Sistemi, "UB-Urban";
- d) Kategoria, "A3 - Zona Rurale Fushore";
- e) Përdorimi, "A32 - Zona Densifikimi";
- f) Njësia, "KE\_01-A32-10";
- g) Zona e mbrojtur, "PO";
- h) KSHT, "35%".





- i) KSHR, "20%.";
- ë) KSHP, "20%.";
- k) Intensiteti, "0.5";

- l) Intensiteti me kusht, "N/A"
- m) Dendësia/Banorë, "20 banorë/ha";
- n) Lartësia, "3 kate";
- o) Lloji i ndërhyrjes, "Krijim, Rinovim, Plotësim";
- p) Shërbime, "Neni 45, pika A5";
- q) PDV, "N/A";
- r) Prioriteti, "-";
- s) Kategoritë e kushtëzuara dhe ndaluara, "Neni 7";
- t) Funkcionet aktuale, "Neni 6";
- u) Sipërfaqe, "0.87ha".

**6. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" shtohet njësi strukturore KE 02-N21-14:**

- a) Treguesit e njësisë janë të njëjtë me ata të njësisë strukturore KE\_02-N21-11 me përjashtim të:
  - i. Njësia, "KE\_02-N21-14";
  - ii. Kushtëzime ligjore, "Në këtë njësi nuk lejohet aplikimi i Vendimit të KKT Nr. 12, datë 27.02.2019 "Për miratimin e Lejeve të Zhvillimit/Ndërtimit nga autoritetet e zhvillimit të territorit, në Njësitë që i përkasin sistemit Urban (UB), Bujqësor (B) dhe Natyror (N)" për arsye të ruajtjes së zonës ku zhvillohet historikisht eventit artistik "Logu i Bjeshkëve";"
- b) Sipërfaqja e njësisë (ha) "2.76";
- c) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.

**7. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" në njësinë strukturore KE 02-N21-11:**

- a) Sipërfaqja e njësisë (ha) nga "5.66" ndryshon në "1.51";
- b) Koordinatat e njësisë jepen në Shtojcën II.

**8. Në "Tabelën e Treguesve të Zhvillimit" shtohet njësi strukturore KE 02-N21-15:**

- a) Treguesit e njësisë janë të njëjtë me ata të njësisë strukturore KE\_02-N21-11 me përjashtim të:
